



SINTEZË E PERIUDHËS 13 Prill-19Prill

Aktivitet i zhvilluar masivisht nga bashkitë: Numri i këshillave bashkiakë të cilët mbajtën mbledhje online shkoi në 60 këtë javë. 39 prej tyre kanë arritur ta bëjnë këtë nëpërmjet video konferencave, ku "Bashki të Forta" ka asistuar 36 këshilla bashkiakë për realizimin e tyre duke ofruar asistencë të vazhdueshme teknike. Aktivitet me shtrirje të gjërë ka qënë dizifektimi i rrugëve dhe i ambjentëve të përbashkëta të banimit. Grupet e patronazhit dhe të vullnetarizmit janë të krijuara dhe funksionojnë në shumicën e bashkive të vendit. Këto grupe kanë ofruar ndihmesë në furnizimet me ushqime, ilaçe apo edhe mbështetje psikologjike. Bashkitë përdorin forma të ndryshme për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve, që kanë më shumë nevojë. Bashkëpunimi me institucionet e qeverisë qendrore dhe asaj lokale është i orientuar drejt vazhimit të zbatimit të masave parandaluese të infeksionit, dhe së fundmi drejt përgatitjes për pritjen e emigrantëve të cilët do të karantinohen për 14 ditë. Bashkitë u angazhuan në shenjëzimin e vendqëndrimeve të qytetarëve dhe disa tregje në zona urbane u riorganizuan. Bashkitë me shtrirje të gjërë në zona rurale kanë ndihmuar fermerët për të zgjidhur aspekte burokratike të lejeve apo kanë vënë në dispozicion transport për nevojat e tyre. Afrimi I sezonit turistik ka bërë që bashki me turizëm detar dhe malor të hedhin hapa tentative për përgatitjen e sezonit turistik, ndërsa janw nw pritje twdhëzimeve nga Ministria e Turizmit. Kwshillim psikologjik wshtw ofruar pwrmes rrugwve tw ndryshme pwr fashat e gruepve nw nevojw.. Bashki të Forta po punon me një numër të konsiderueshëm bashkish që shërbimi psiko-social të ofrohet për grupmoshat 3-6 sipas praktikës së mirë të vënë në zbatim nga bashkia Durrës.

Gjatë periudhës së emergjencës bashkitë kanë shkëmbyer eksperiencën midis tyre me zgjidhjet funksionale që ata kanë aplikuar, ku raporti javor i Bashki të Forta ka arritur t'i sjelli në një format të përmbledhur. Në total janë 37 praktikat e ripërsëritura më së shumti nga java në javë gjatë kësaj periudhe. Në javën e dytë bashkitë mbështetën me fondet e tyre apo donacione familje në nevojë (21 bashki). Në javën në javën e tretë u identifikua intensifikimi i vendimarrjeve online (46 bashki), ndërsa në javën e katërt praktika më e ripërsëritur kishte të bënte me riorganizimin e tregjeve dhe masave shtesë për distancat sociale (31 bashki).

Tendencat e financave vendore : Në dy javët e para të emergjencës Covid-19, bashkitë e vendit i janë përgjigjur situatës duke përdorur kryesisht fondin e emergjencës dhe atë të rezervës për të ofruar shërbime sociale-humanitare apo të dizifektimit. Në javët në vijim, me rritjen e kërkesës janë vënë re shkurtime të shpenzimeve të planifikuara nga fondet e destinuar për shërbime publike, kryesisht ujësjellës-kanalizime, infrastrukturë rrugore apo të

ardhura të planifikuara nga një vit më parë. Për një njohje më të thelluar mbi vlerat e rialokuara në funksion të COVID 19 ([kliko për të parë grafikët](#)), të cilët bazohen në vëzhgimin e vendimeve të 21 këshillave bashkiake. Vihet re që bashkitë kanë shtuar para në zërat: mbrojtje civile dhe emergjenca, duke vazhduar me përkujdesjen sociale, burimet njerëzore apo menaxhimi i mbetjeve.. Bashki të ndryshme kanë aplikuar lehtësira fiskale për të ulur barrën për kategori të ndryshme taksa-paguesish si (i) shtyrje afati për pagesat e taksave dhe tarifave vendore; (ii) ulje e barrës fiskale për grupe të ndryshme (iii) ulje e tarifave të ushqimit në kopshte dhe çerdhe.

Kontribut i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) dhe Shoqatave të Pushtetit Vendor: AMVV mbështeti gjatë vizitës në Shkodër, aktivitetin e përfaqësuesit të Këshillit Ndërmintor të Emergjencave Civile në funksion të vënies së kontroll të situatës së shpërhapjes së virusit në qytet. Agjencia asistoi vendimarrjen për përgjysmimin e orareve të tregjeve të qytetit, vendosjen e një rotacioni për subjektet tregtare, si dhe mbylljen tregut i tregu për një periudhë 2 javore. Agjencia kërkoi angazhim më të madh nga ana e këshilltarëve në drejtim të vënies në kontroll të situatës. Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV) vazhdon të koordinimin Qeveri Qendrore - Qeveri Lokale në drejtim të përfshirjes së ambulantëve në grupin e të vetëpunësuarëve që do të mbështeten nga paketa e QQ. SHAV dhe Shoqaqa e Bashkive Shqiptare (SHBSH) morën pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Brendshme "Koordinimi i grupit tematik të donatorëve për decentralizimin; me fokus të veçantë përgjigjen e pushtetit vendor për Covid-19". (SHAV) prezantoi punën e bërë dhe sfidat e së ardhmes: (i) Vazhdimi i mbështetjes së familjeve në nevojë, (ii) Mungesa e burimeve financiare si pasojë e mosmbledhjes së të ardhurave të planifikuara, (iii) Mbështetja e burimeve njerëzore në bashki. SHAV dhe SHBSH i bënë apel donatorëve për të mbështetur direkt bashkitë financiarisht. Kjo ndihmë të orientohet drejt bashkive dhe qarqeve për të asistuar individët ose familjeve në nevojë të cilët nuk trajtohen nga mbështetja e QQ. Projekti MD.net i programit Interreg MED, zbatuar dhe nga SHBSH ka kryer disa seminare online të hapura për publikun me fokus tek skenare të ndryshme të zhvillimit të pandemisë dhe adresimi i tyre, rëndësisë së dietës dhe aktivitetit fizik në kohë të distancimit fizik.

PËR MË SHUMË INFO KOMUNIKO ME KOORDINATORIN RAJONAL

[Kliko këtu](#)

QEVERISJE DEMOKRATIKE

| Problemi | Modalitetet e zgjidhjes | Ku ka ndodhur |
|--|--|---|
| <p>Vendimmarrja Përdorimi i mjeteve elektronike & pamundësi për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit në kushtet e "distancës sociale"</p> | <ul style="list-style-type: none"> Përmirësim i ndjeshëm i realizimit të vendimmarrjes në distancë që prej fillimi i masave shtrënguese. 60 nga 61 këshilla bashkiakë kanë arritur të zhvillojnë mbledhje online (Finiqi ende për ta realizuar). Pas daljes së Aktit Normativ Nr. 3 datë, 15.03.20207, u shënuan shtatë vendim-marrje online (1 me skype dhe 6 me email/whatsapp) si dhe 1 vendimarrje me vendim qarkullues. 39 këshilla bashkiakë nga 60 kanë përdorur video konferenca (Zoom apo Skype), ndërsa pjesa tjetër përdor ende Whatsapp. Bashki të Forta ka asistuar drejtëpërdrejtë 36 prej tyre në realizimin e mbledhjeve me video konferencë. Gjithashtu BTF ka dekurajuar përdorimin e vendimeve qarkulluese dhe po punon aktivisht me 21 këshilla të tjerë për të kaluar nga Whatsapp në formate aktive me video dhe zë. | <p>60 bashki kanë marrë vendime nëpërmjet vendimarrjes elektronike</p> <p>https://tirananeews.al/covid-19-mbledhje-online-e-keshillit-te-bashkise-mat/</p> |
| <p>Mbikqyrja Monitorimi i grupeve të patronazhit në terren mbi shërbimin që ofrohet</p> | <ul style="list-style-type: none"> Përpjekje për fuqizimin e rolit mbikqyrës të këshillit për efektivitetin e menaxhimit të ndihmave në 20 Bashki : këshillim për formulim më transparent të projekt vendimeve (veçanërisht ato që lidhen me ndihmat). BtF e gatshme për të ndihmuar. Raportim i ekzekutivit për llogari të këshillit bashkiak mbi procesin e shpërndarjes së ndihmës dhe monitorim i listës së përfituesve. | <p>Mat, Klos, Kruje, Bulqizë, Delvinë</p> <p>Pogradec, Kolonjë, Devoll, Shijak</p> |
| <p>Veprime të tjera Aktiviteti i këshillit kufizuar vetëm për aspekte të emergjencës</p> | <ul style="list-style-type: none"> Asistencë teknike për 23 këshilla bashkiakë nëpërmjet trajnimeve ditore online (kliko këtu) për kryetar dhe sekretar të keshillave bashkiak (40 pjesmarrës). Fokus i trajnimit, "Rregullorja e funksionimit të këshillit", "Rregullorja e Konsultimeve me Komunitetin", "Hartimi i Planit të Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak dhe Buxhetimit". 40 rregullore të funksionimit të këshillit janë miratuar. Javën e fundit u miratuan 3 "Rregullore e funksionimit të Këshillit", 3 | <p>Urë Vajgurore, Vlorë, Delvinë, Kurbin, Mirditë</p> <p>Konispol, Divjakë dhe Fier</p> |

“Rregullore të Konsultimeve me Komunitetin” dhe 3 “Kod i sjelljes dhe Etikës” në mbledhjet online që zhvillojnë këshillat bashkiak.

Nxitje e Vullnetarizmit

- Këshilltarët krahas rolit vendimarrës dhe monitorues vazhdojnë angazhimin në grupet e patronazhit si vullnetarë në 26 bashki.
- Asistencë për familjet në nevojë apo të moshuarit e vetmuar për shërbime bazë, ndihmë ushqimore, ushqim të gatuar apo ilaçe duke koordinuar mes grupeve të patronazhit dhe vullnetarëve në 46 bashki.

Urë Vajguore, Kuçovë, Berat, Mirditë, Kukës, Shijak, Durres, Has, Tropojë

Transparencë, Ndërgjegjësim dhe Ilogaridhënie

- Hapësirë e posaçme në websitin e bashkisë e dedikuar për zbatimin e masave në tregje, ankesave, raportime të abuzimeve apo shqetësimeve të qytetarëve.
- Transmetim live i mbledhjes së këshillit bashkiak në platforma të medias sociale dhe në TV lokale në respektim të udhëzimit të BTF.
- Informim nëpërmjet hapësirës elektronike mbi masat e shtrënguese apo për kuadrin ligjor të situatës emergjente. Raportim i punës së zhvilluar nga të gjitha strukturat e bashkisë ofrohen në faqen e facebook-ut dhe medias lokale në 21 Bashki.
- Publikimi në faqen e ëeb të bashkisë dhe në rrjetet sociale të listës së familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.
- Mesazh sensibilizimi në media sociale për zbatimin e rregullave të sigurisë për mbrojtje nga shpërhapja e COVID-19 nga anëtarët e këshillit bashkiak.

Urë Vajguore, Durres, Skrapar, Elbasan, Librazhd, Belsh, Cërrik, Peqin, Prrenjas, Mirditë, Dibër, Bulqizë, Klos, Mat

Korçë

Shkodër, Fier

<https://www.facebook.com/Tvkombi/videos/640151233499831/?vh=e&d=n>

Berat, Skrapar, Has, Tropojë

Durrës,

Shkodër

BASHKËPUNIMI KOMBËTAR-RAJONAL-QEVERISJE VENDORE

| Problemi | Modalitetet e zgjidhjes | Ku ka ndodhur |
|------------------------------|---|----------------|
| Koordinim për veprim efektiv | <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunim midis bashkisë dhe prefekturës për implementimin e masave të rrepta për frenimin e zinxhirit të infektimit. Vënie në zbatim të vendimit për mbyllje provizore të tregjeve ku ka grumbullim të lartë qytetarësh dhe alternimit të ditëve në të cilat tregtarët mund të ushtrojnë veprimtari në tregje. | Shkodër, Krujë |

- Bashkia asiston prefektin dhe policinë e shtetit për zbatimin e urdhërit të karantinimit 14 ditor të emigrantëve të mbërritur nga pikat kufitare pranë në territorit e bashkisë, duke siguruar monitorim nga ana e policisë bashkiake dhe plotësimit për nevoja ushqimore apo për barna gjatë qëndrimit, me anë të grupeve të patronazhimit. Devoll, Korçë, Malësi e Madh, Pogradec
- Prefekti koordinon me bashkinë dhe komisionin e emergjencave zbatimin e masave preventivuese sanitare që po aplikohen nga tregtarët. Kukës
- Bashkëpunim me komunitet fetare për të përcjellë nevojën për zbatimin e rregullave; angazhim i shoqërisë civile për të ndërgjegjësuar dhe informuar qytetarët përkrah fuqizimit të masave ndëshkuese. Shkodër
- Video konferencë e maturantëve të shkollave të mesme mbi shqetësimet e sigurisë dhe shëndetit mendor në lidhje me provimet e maturës. Bashkia përfaqson interesin e qyterarëve të saj duke komunikuar drejtpërdrejtë me Ministrinë e Arsimit mbi shqetësimet e tyre dhe vendosur në dispozicion psikologe për trajtimin e stresit. Shijak
- Mobilizim i fondit të emergjencës së qarqeve në funksion të mbështetjes së komuniteteve vendore 12 Qarqet

PËRMBUSHJA E FUNKSIONEVE VENDORE

| Problemi | Modalitetet e zgjidhjes | Ku ka ndodhur |
|---|--|---|
| Shërbimet Sociale Fonde te pamjaftueshme për të përballuar emergjencën COVID me burimet e alokuara financiare në buxhetet vjetor (veçanërisht në mbështetje të shtresave në nevojë) | <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje e familjeve në nevojë, jetimë, rome/egjiptiane apo ato të goditura nga tërmeti, me ushqime dhe materiale të nevojshme të ofruara nga fondet e bashkive, donacione private ose fetare në 19 Bashki. | Urë Vajgurore, Devoll |
| Ofrim shërbimesh sociale | <ul style="list-style-type: none"> • Ofrimi i numrave të punonjësve social të bashkisë dhe aplikacion për denoncime apo ndjekje rastesh dhune në familje • Socializim për të moshuarit që jetojnë vetëm, vullnetarë të dedikuar për telefonata ditore. | Dibër, Klos, Malesi e Madhe, Fushe Arrëz, Shijak, Lushnjë, Selenicë, Himarë, Pogradec, Lezhë, Durrës, Gramsh, Mirditë Dropull, Përmet, Dibër Pogradec, |

- Ndihmë për ngritjen e infrastrukturës online për gratë e dhunuara, në mënyrë që tregtimi i punimeve artizanale jashtë vendit të mos ndërpritet.
- Linjë telefonike e dedikuar për keshillimin psikosocial në distancë, të organizuar nga Bashkia Elbasan në bashkëpunim me Universitetin "Aleksander Xhuvani" dhe "Urdhërin e Psikologut".
- Numër telefoni në dispozicion për shërbime psiko-sociale. Identifikimi i familjeve ose individëve që kanë nevojë për konsulta psikologu, dhe ofrimi i psikologut të Bashkisë në shtëpi. Bashkëpunim me organizatat lokale që kanë psikologë për të asistuar qytetaret në shtëpi duke respektuar distancën dhe rregullat.
- Përfshirje e psikologëve tek grupet e patronazhit për ofrimin asistencë të familjeve me nevojë.
- Fletëpalosje informative hartuar nga OBSH, Unicef, USAID, CDC etj dhe organizata të kujdesit për fëmijët mbi prindërimin efektiv në kushtet e karantinimit.
- Thirje për sensibilizim drejtuar emigrantëve, bashkëatdhetarëve dhe bizneseve duke grumbulluar ndihma për familjet në nevojë.

Elbasan

Dibër

Kukës

Kamëz

Mat, Kukës, Klos, Përmet, Roskovec, Divjakë, Fier, Mallakastër, Patos, Lushnje, Pustec, Devoll, Maliq

Evidentimi i familjeve në nevojë dhe dërgimi i listave pranë Komitetit të Emergjencave

- Krijimi i procedurave të brendshme për menaxhimin e zinxhirit të shpërndarjes së ndihmës duke u siguruar për evidentimin e njerëzve në nevojë dhe parandalimin e zinxhirit të infeksionit. Bashkitë bëjnë transparente shpërndarjen e ndihmave në këshill dhe public në 24 bashki.
- Asistencë nëpërmjet telefonit për njerëzit që aplikojnë për herë të parë për ndihmë ekonomike online.

Has

Fier, Lushnjë, Patos, Mallkastër, Roskovec, Divjakë, Gramsh, Devoll

Siguria Publike

Përbushja e detyrave funksionale edhe në kohë emergjence

- Riorganizim i tregjeve publike në hapsirat ekzistuese ose dekoncentrim i tyre nëpër lagje, për të shmangur grumbullimin e konsumatorit në disa pika tregëtimi si dhe implementim i tuneleve, masave dizifektuese si dhe përdorimit të pajimeve mbrojtëse.
- Shenjëzim i dallueshëm në pika shërbimi tregtar për ruajtjen e distancës sociale në 37 bashki. Policia monitoron zbatueshmërinë

Tiranë, Vlorë, Fier, Durrës, **Elbasan, Shkodër, Sarandë, Kukës**

Divjakë, Devoll, Pogradec, Kolonjë, Shkodër, Rrogozhinë, Kamëz, Skrapar

Shërbime publike

- Bashkia ofron transport për fermerët e vegjël që të tregtojnë prodhimet në tregjete qytetit. Transport i ofruar për furnizimin me ushqime për dyqaneve të fshatrave.
- Mbulim i shpenzimeve funerale nga bashkia për qytetarë pa të afërm dhe mundësi financiare.
- Transport falas për të sëmurët kronikë, në spitalet rajonale dhe numër telefoni të dedikuar për ata që kanë nevojë për këtë shërbim.
- Ndihmë për gjenerimin e autorizimeve të qarkullimit rrugor nga punonjësit e bashkisë për fermerët/blegtorët që nuk zotërojnë njohuri të teknologjisë së informacionit.
- Zyra e bujqësisë asiston fermerët për garantimin e transportin e inputeve bujqësore si dhe koordinon me policinë duke ofruar listat e fermerëve në punë për garantimin e vazhdimin të aktiviteteve bujqësore/blegtorale.

Gjirokastrë, Përmet, Memaliaj

Memaliaj, Tiranë

Shijak

Roskovec, Dropull, Bulqizë

Kolonjë, Maliq, Devoll

Sezoni Turistik

- Nxitje për përfundimin e punimeve të infrastrukturës nga kontraktorët dhe përgatitje për çeljen e sezonit turistik në rastin e lehtësimit të masave për Covid-19.

Lezhë, Sarandë, Pogradec

Tërmet, Zjarr

- Masa përgatitore për sezonin turistik që parashikojnë distanca prej 4 metrash nga çadra në çadër si dhe spostim i vijës së parë nga 7 metra në 10 metra.
- Bashkia mbështet konkursin online për inovacionin në fushën e turizmit dhe merr pjesë në konferencën online të mbajtur me biznese që operojnë në zona të mbrojtura malore. Përgatitje për pritjen e turistëve në rast të reklaksimit të masave mbrojtëse.

Bashkitë me turizëm detar/liqenor

Vau Dejës, Tropojë

Veprimtari që vjiojnë si normalisht përtej COVID-19

- Monitorim i pyjeve dhe kullotave si dhe ndalim i ngarkesave me dru nga punonjës së bashkisë dhe policisë bashkiake. **Lezhë, Mirditë, Klos, Mat**
- Bashkia ka krijuar një shërbim të ri online, për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve të dëmtuar nga tërmeti, banorët mësojnë për statusin e aplikimit, kalimin e kësteve të bonusit etj. **Durrës**
- 24 bashki po shfrytëzojnë situatën për të mbyllur punë publike infrastrukturore apo mirëmbajtje në kushtet e lëvizjes dhe transportit të lehtësuar nga COVID-19 (sheshe, trotuaresh, ujësjellësa, shkolla, pastrim kanalesh, mbjellje pemësh) **Belsh, Korçë, Kruje, Durres, Shijak, Kurbin, Shkodër, Selinica, Delvinë, Finiq, Vau i Dejës, Pogradec, Sarandë, Vlorë, Himarë**

Aktivitete Zbavitëse

- Konkurse që ndihmojnë të rinjtë dhe të rriturit në bashkëpunim me median lokale, apo duke zhvilluar aktivitete online nëpërmjet medias sociale dhe autoriteteve të kulturës. **Lezhë, Vlorë, Klos, Dibër, Kukës, Pogradec, Përmet, Patos, Lushnje, Shijak, Ura Vajgurore, Bulqizë, Mat**

Parashkollori

- Biblioteka e qytetit ofron një numër librash online për shfletim **Lezhë, Skrapar**
- Edukatorët ofrojnë programin mësimor dhe orë zbavitëse për fëmijët përmes medias online në bashkëpunim me prindërit. **Durrës, Dibër, Bulqizë, Klos, Mat, Krujë, Shijak, Kukës, Pogradec, Vlorë**
- **Me iniciativën e BtF, 24 bashki kanë gatishmëri për të prioritetuar aksionet e tyre për bashkëpunuar me ZVAP-et për ofrimin e shërbimit psiko-social për fëmijët 3-6 vjeç, bazuar në praktikën e mirë të bashkisë Durrës. 3 fëmijë 3-6 vjeç të mbështetur në Durrës gjatë javës** **Skrapar, Ura Vajgurore, Durrës, Dibër, Bulqizë, Klos, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Vlorë, Himarë, Selenicë, Korçë, Devoll, Maliq, Mallakastër, Roskovec, Gjirokastër, Shkodër, Pukë, Kamëz, Lezhe.**

Shënim*: Me ngjyrë të kuqe janë bashkitë që janë shtuar apo që po replikojnë një praktikë të vënë në jetë më parë nga bashki të tjera.

Shënim:** Një falenderim i veçantë shkon për media kombëtare si Top Channel, Vizion Plus, Ora Neës apo media lokale Apollon TV, Berati TV, TV Mat, TV Dibër, Kombi, Argjiro, Jugu Neës, Tirana Neës, Bulevard Neës, Durrës Lajm, Lexo.com, Lezha Neës, që e kanë shpërndarë raportin si dhe kanë evidentuar zgjidhjen e dhënë nga bashkitë për problematikat e krijuara gjatë emergjencës COVID-19